

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TRINIUM LEGAL BANKING AND FINANCE ” Sh.p.k.

KAPITULLI I
EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Sot, më datë 22.08.2023, personat e mëposhtëm:

- **Z.MARCO SACCONI**, i biri i Idelmo Mario dhe Raffaelina, lindur më 05.09.1964 në Napoli dhe banues ne Avellino, Itali, mbajtës i pasaportes me nr. YB7665468,
 - **Z.GIACINTO RUBICONDO** i biri i Giovanni dhe Anna, lindur me 14.04.1964 ne Avellino dhe banues ne Avellino, Itali mbajtës i pasaportes me nr. YB7667056
 - **Z.ALAN D'ORLANDO**, i biri i Pasquale dhe Elfa lindur me 26.06.1980 ne Milano dhe banues ne Milano, Itali mbajtës i kartes se identitetit me nr. CA60087IK
- vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

Neni 1
Themelimi

- 1.1 Emri i shoqërisë është “TRINIUM LEGAL BANKING AND FINANCE ” Sh.p.k., këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.4 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2
Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Qemal Stafa, Pall. Hapesira X, Hyrja 32, Njesia nr.1, Yzberish, Tirane.
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3
Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:
Konsulencë dhe asistencë ekonomike, financiare dhe investime; Hulumtimi dhe analiza e tregut; Aktivitete dhe konsulencë për pasuri të paluajtshme në Projekte / shpërndarje, Aktivitete Tregtare dhe Marketing, Aktivitete Import-eksport; Dhënie me qera për mjete tokësore (automjete), Ajrore dhe Detare; Menaxhimi të Pasurive dhe trashëgimisë, menaxhim të aseteve, Turistike dhe Tregtare; Planifikimi/projektimi, menaxhimi, ndërtimi i pasurive të paluajtshme; Veprimtarindihmëse, këshilluese, trajnuese,

Ala D'Orlando

M. M.

- menaxhuese per subjekte private/biznesore;aktivitete partneriteti dhe sipërmarrje të përbashkëta në përgjithësi dhe çdo aktivitet tjetër sipas ligjit.
- 3.2 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten leje, licenca dhe/ose autorizime përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve, licencave dhe/ose autorizimeve.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT-PJESËT E KAPITALIT

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

Kontributi i ortakëve do të jete në para dhe në natyrë si vijon:

1. Vlera prej 1.000.000 Eur (nje milion), e ekuivalentuar ne Lek në shumën 105,930,000 (njëqind e pesë milion e nëntëqind e tridhjetë mijë) Lek.
2. Vlera ne natyre si vijon:

Lista e veprave:

- Vepra n. 1 - “Still Life Wich Melon”, vlera prej 10.300.575 €.
- Vepra n. 2 – “Muerte of a Picador”, vlera prej 11.200.000 €.
- Vepra n. 3 – “Death of a Picador”, vlera prej 12.100.000 €.
- Vepra n. 4 – “Still Life With Pears, Grapes, and Pomegranatas”, vlera prej 10.300.575 €.
- Vepra n. 5 – “Busto de Anciano”, vlera prej 4.015.761 €.
- Vepra n. 6 – “Ensenanza al Aire Livre”, vlera prej 9.300.000 €.
- Vepra n. 7 – “Retablone de Virgen del Rosario”, vlera prej 31.178.815 €.

Vlera totale e kapitalit ne natyre; 88,395,726 € e ekuivalentuar ne Lek 9.363.759.255 Lek.

3. Kapitali i Shoqërisë zotërohet nga Ortakët e mëposhtëm, i ndare ne 3 (tre) kuota:

Ortaku **Z.MARCO SACCONI**

Vlera e kapitalit Para: 34,956,900 Lek

Numri i pjesëve 1,00

Pjesëmarrja në përqindje (%) 33,00

Ortaku **Z.GIACINTO RUBICONDO**

Vlera e kapitalit Para: 34,956,900 Lek

Numri i pjesëve 1,00

Pjesëmarrja në përqindje (%) 33,00

Ortaku **Z.ALAN D’ORLANDO**

Vlera e kapitalit Para: 36,016,200 Lek

Natyrë: 9.363.759.255 Lek

Numri i pjesëve 1,00

Pjesëmarrja në përqindje (%) 34,00



- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 6

Transferimi i Pjesëve-Kuotave

- 6.1 Çdo Ortak mund t'ia transferojë pjesët e tij në kapitalin e Shoqërisë çdo pale të tretë, me kusht që Ortaku transferues t'u ketë njoftuar më parë me shkrim Ortakëve të tjerë të paktën 1 muaj para ("**Periudha e Njoftimit**") numrin e pjesëve për t'u shitur, çmimin e shitjes, identifikimin e palës së tretë dhe çdo kusht tjetër lidhur me transferimin e pjesëve. Ortakët e tjerë duhet t'i përgjigjen njoftimit të Ortakut transferues nëse dëshirojnë të blejnë pjesët sipas kushteve të vendosura në njoftim brenda Periudhës së Njoftimit. Në rast të një përgjigjeje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Ortaku transferues mund të procedojë me transferimin e pjesëve te pala e tretë.

KAPITULLI III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 7

Asambleja e Përgjithshme

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.
- 7.2 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratorët;
 - Emëron dhe shkarkon administratorët;
 - Emëron dhe shkarkon ekspertin(ët) kontabël dhe/ose likuiduesin(ët) e Shoqërisë;
 - Përcakton shpërblimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuiduesve;
 - Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratorët;
 - Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
 - Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
 - Merr vendim për riorganizimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
 - Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 8

Thirrja

- 8.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori(rët) apo secili prej Ortakëve sipas legjislacionit në fuqi.
- 8.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Ala Duhul

Asja

M/S

- 8.3 Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës, për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
- 8.4 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë. Administratori(ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 9

Procesi i vendimmarrjes

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që është e nevojshme, por në çdo rast të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave të Shoqërisë. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë, në lidhje me çështje për të cilat ligji nuk kërkon një shumicë të cilësuar, përcaktuar në pikën 9.4 më poshtë.
- 9.4 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar prej 66 % e votave të ortakëve të pranishëm në lidhje me:
- Ndryshimin e Statutit;
 - Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - Shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
 - Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme për vendimet sipas pikës 9.4 quhet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm Ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave të Shoqërisë. Në mungesë të kuorumit të kërkuar, mbledhja shtyhet për 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.



Neni 10

Administratori

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratoret e shoqërisë janë:
- Z.GIACINTO RUBICONDO**, lindur me 14.04.1964 ne Avellino dhe banues ne Avellino, Itali mbajtës i pasaportes me nr. YB7667056
- Z.ALAN D'ORLANDO**, lindur me 26.06.1980 ne Milano dhe banues ne Milano, Itali mbajtës i kartes se identitetit me nr. CA60087IK
- 10.3. Mandatet i Administratoreve janë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 10.4. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratoret, te dy sebashku apo vecmas njeri-tjetri, kjo per sa i perket vetem perfaqesimit apo negocimit. Ne te gjitha nenshkrimet e kontratave, marrveshjeve apo cdo marrdhenie kontraktuale me palet e treta do te nenshkruhet nga te dy Administratoret. Çdo transferte bankare apo veprim bankar do te jete me nenshkrimin dhe aprovimin e te dy Administratoreve.



Ne rast se ndonje dokument eshte i nenshkruar vetem nga njeri nga Administratoret ose eshte kryer ndonje veprim bankar pa nenshkrimin e te dyve, ateher ky dokument apo veprim eshte i pavlefshem.

Administratoret Administratoret jane pergjegjes personalisht per shkelje te ligjit dhe te Satutit dhe per gabimet e kryera gjate administrimit te Shoqërisë.

- 10.5 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.
- 10.6 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblesë së Përgjithshme për emërimin administratorit, administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;
 - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
 - Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
 - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe balanceve të konsoliduara, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
 - Dorëzimin në QKB të dokumenteve dhe të të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
 - Raportimin në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
 - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 10.7 Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure një palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 10.8 Administratori është pergjegjes ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR - SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 11

Viti Financiar

- 11.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 11.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja e Fitimeve

- 12.1 Pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimeve.



- 12.2 Në rast se pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare Shoqëria rezulton me humbje, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me mbulimin e humbjeve.

**KAPITULLI V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Neni 13

Ligji i Zbatueshëm

- 13.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

Neni 14

Të ndryshme

- 14.1 Ky Statut është hartuar dhe nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe në atë italiane, me të njëjtën vlerë secila.

ORTAKET

Z.MARCO SACCONI



Z.GIACINTO RUBICONDO



Z.ALAN D'ORLANDO

